



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), nenit 10 dhe 16 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2014 miratoi si në vijim:

RREGULLORE PËR LICENCIMIN E MENAXHUESVE TË MJETEVE PËR MJETET E FONDEVE PENSIONALE

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet, që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e licencës për menaxhuesit e mjeteve për mjetet e фондеве pensionale (në vijim menaxhuesit e mjeteve).
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për të gjithë aplikuesit për licencë nga BQK-ja për t'u themeluar si menaxhues i mjeteve në Republikën e Kosovës.

Neni 2 Përkufizimet

Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe (në vijim Ligji për Fondet Pensionale) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:

“Menaxhimi i Mjeteve” nënkupton drejtimin, investimin, riinvestimin, strukturimin, ristrukturimin, përvetësimin, shitjen, transferimin ose bartje tjetër të mjeteve të pensioneve dhe interpretimin e këshillës në lidhje me këtë.

“I licencuari” nënkupton subjekt juridik i licencuar nga BQK-ja sipas kësaj Rregullore.

“Aksionar kryesor” nënkupton personin që posedon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo

tërthorazi, së bashku apo në bashkëveprim me persona të tjerë 10% ose me tepër të çfarëdo klase

të aksioneve me të drejtë vote në menaxhuesin e mjeteve.

“Menaxher” - nënkupton personin fizik me përgjegjësi menaxhuese dhe i cili është ose kryeshef ekzekutiv ose nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të kryeshefit ekzekutiv gjatë funksionimit të përditshëm të menaxhuesit të mjeteve.

“ Kapital aksionar” nënkupton pagesën në kapital dhe tepricat e pakufizuara.

Neni 3

Veprimtaria e Menaxhuesit të Mjeteve

1. Bazuar në nenin 10 të Ligjit për Fondet Pensionale, vetëm subjektet juridike, që janë të licencuar nga BQK-ja, mund të ushtrojnë veprimtarinë e Menaxhimit të Mjeteve.
2. Askush nuk mund të ushtrojë veprimtari të Menaxhimit të Mjeteve në Republikën e Kosovës pa siguruar paraprakisht licencë nga BQK-ja.
3. Menaxhuesi i Mjeteve i licencuar nuk mund të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër përveç shërbimeve direkte që janë karakteristike për këtë aktivitet.
4. Menaxhuesi i Mjeteve i licencuar do t'i nënshtrohet rregullimit dhe mbikëqyrjes nga ana e BQK-së.

Neni 4

Minimumi i kapitalit

1. Shuma minimale e kapitalit aksionar e kërkuar për një Menaxhues të Mjeteve është 4,000,000, (katër milion) euro;
2. Shuma e kërkuar nga paragrafi 1 i këtij neni mund të ndryshohet nga BQK-ja.
3. Kapitali aksionar sipas këtij neni do të investohet sipas udhëzimeve të BQK-së.
4. Menaxhuesi i Mjeteve në çdo kohë duhet të mbajë kapitalin aksionar në shumën e kërkuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 5

Kërkesat për aplikim

1. Të interesuarit për licencë për Menaxhimin e Mjeteve Pensionale duhet të përmbushin të gjitha kërkesat sipas Ligjit për Fondet Pensionale, që janë të nevojshme për procesin e aplikimit sipas akteve të brendshme të BQK-së. Aplikuesi mund të kërkojë format e nevojshme të aplikimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre nga BQK-ja apo të njëjtat mund t'i gjejë në faqen zyrtare të BQK-së.
2. Aplikacioni nënshkruhet nga aksionari/ët themelues/ë dhe dorëzohet në BQK, me prezencë

fizike të aksionarit ose përfaqësuesve të aksionarëve themeluesë të menaxhuesit të mjeteve të propozuar. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për Pensione dhe me këtë Rregullore.

3. Dokumentacioni i ofruar duhet të jetë në një të njërit nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuara.

Neni 6

Kriteret për Licencim

1. Personi që aplikon për licencim si Menaxhues i Mjeteve përveç kërkesave të nenit 10 të Ligjit për Fondet Pensionale, duhet t'i plotësojë kushtet, si në vijim:
 - a. të jetë i regjistruar si person juridik në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
 - b. të jetë në gjendje të mirë financiare të dëshmuar me pasqyra financiare të audituara dhe të mos ketë obligime tatimore të papaguara;
 - c. themeluesit, drejtorët dhe menaxherët e kompanisë së propozuar të mos jenë të dënuar për ndonjë vepër penale dhe t'i plotësojnë kërkesat e BQK-së i përshtatshëm dhe i duhur;
2. Kërkesës për licencim si menaxhues im duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:
 - a. formulari i BQK-së;
 - b. certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe statutin;
 - c. biografite e plota të themeluesve, si dhe pasqyrat financiare nëse janë të aplikueshme,
 - d. listën e anëtarëve të propozuar për bordin e drejtorëve dhe menaxherëve, biografite e plota të tyre, duke përfshirë dëshmitë, që vërtetojnë përgatitjen dhe përvojën relevante
 - e. struktura organizative (organogramin);
 - f. plani i biznesit;
 - g. emri dhe detalet kontaktuese të firmës audituese për menaxhuesin e mjeteve;
 - h. dokumenti që vërteton se Menaxhuesi i Mjeteve i propozuar disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë si Menaxhues i mjeteve pensionale, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave në BQK;
 - i. lista e bankave dhe adresat e tyre me të cilat aplikuesi ka aranzhime bankare dhe përshkrimi i shkurtër i aranzhimeve të tilla.
 - j. dëshmi e pagesës së tarifës së aplikimit për licencë;
 - k. dëshmi që vërteton pagesën e kapitalit minimal të kërkuar sipas kësaj Rregullore;
3. Përveç kërkesave të lartcekura BQK-ja mund të kërkojë informata apo dokumentacion shtesë.

Neni 7
Kërkesat për Menaxhuesit e Jashtëm të Mjeteve Pensionale

1. Menaxhuesi i mjeteve që gjendet jashtë Kosovës, i cili aplikon për të kryer veprimtari të menaxhimit të mjeteve pensionale në Kosovë, përveç kushteve të kësaj Rregulloreje duhet të plotësojnë edhe kërkesat si më poshtë:
 - a) Dëshmi prej autoritetit mbikëqyrës ose rregullator të shtetit amë të aplikuesit që konstaton se aplikuesi është në “gjendje të mirë” dhe në “pajtim” me të gjitha ligjet dhe kërkesat rregullatore në atë juridiksion të huaj;
 - b) Dëshmi mbi licencimin e saj nga rregullatori bankar, shërbimet financiare dhe tregjet e kapitalit rregullator të një shteti anëtar të OECD-së dhe BE-së;
 - c) Dëshmi që vërteton gjendjen financiare e audituar për 5 vitet e fundit. Aty ku aplikohet, gjithashtu duhet të parashtrohet gjendja financiare e kompanisë amë të aplikuesit dhe kompanitë e afërta për 5 vitet e kaluara;

Neni 8
Tarifat për Menaxhuesit e Mjeteve Pensionale

1. Aplikuesi që kërkon licencë si Menaxhues i Mjeteve Pensionale duhet të paguajë tarifat e licencimit dhe të mbikëqyrjes së pensioneve në shumat e aprovuara nga BQK-ja.
2. Tarifa e aplikimit për licencë nuk rimburohet edhe në rast të refuzimit të kërkesës për licencë nga BQK-ja.

Neni 9
Afati i shqyrtimit të kërkesës për Licencë

1. BQK-ja bën shqyrtimin e dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore.
2. BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon kërkesën për licencë si menaxhues i mjeteve pensionale brenda 90 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për licencë. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin.
3. Data e pranimit të kërkesës për licencë konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat e kësaj Rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuesit nga BQK-ja.
4. BQK-ja brenda 15 ditë pune pas datës së pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar.
5. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë Rregullore, BQK-ja e njofton për mangësitë ose për mospërputhjet me

dispozitat e kësaj Rregullore së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacionin shtesë.

6. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencë nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 1 muaji pas njoftimit të BQK-së sipas paragrafit 5 të këtij neni. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës/aplikacionit për licencë, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.

Neni 10 Karakteristikat e Licencës

1. Licenca jepet me shkrim për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk është e transferueshme.
2. Nëse brenda (12) muajve nga data e licencimit, menaxhuesi i mjeteve nuk e fillon veprimtarinë, licenca do të revokohet.

Neni 11 Organizimi dhe Qeverisja e Menaxhuesit të Mjeteve

1. Menaxhuesi i mjeteve do të drejtohet nga bordi i drejtorëve, i cili do të përbëhet nga numër tek prej jo me pak se 5 anëtarë me të drejtë vote.
2. Personat që emërohen për anëtarë të bordit drejtues duhet të jenë persona me integritet të njohur dhe duhet të posedojnë aftësi dhe përvojë profesionale së paku 5 vite në çështjet e pensionit, të financave, të investimeve dhe të sigurimit.
3. Çdo person që është apo do të jetë aksionar kryesor, drejtor, menaxher i menaxhuesit të mjeteve duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për mbajtjen e një posti të posaçëm, siç kërkohet nga BQK-ja.
4. Asnjë person nuk mund të bëhet aksionar kryesor, drejtor apo menaxher pa marrjen e miratimit paraprak nga BQK-ja.
5. Për çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë rregullore për sa i përket qeverisjes do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Neni 12 Transaksionet e Menaxhuesit të Mjeteve që kërkojnë aprovimin paraprak

1. Aktivitetet në vijim kërkojnë aprovim paraprak nga BQK:
 - a) ndryshimet në aktin e themelimit dhe statutin;
 - b) ndryshimi i emrit të institucionit;

- c) hapja, zhvendosja dhe mbyllja e zyrave të institucionit;
- d) shitja apo transferimi i biznesit të tij një entiteti tjetër;
- e) bashkimi apo shkrirja e menaxhuesit të mjeteve;
- f) të gjitha transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin e paguar fillestar që sjellin te ndryshimi i pronësisë së aksionarëve, të cilët posedojnë dhjetë përqind (10%) apo më shumë të kapitalit aksionar dhe/apo të drejtave të votës në menaxhuesin e mjeteve;
- g) Menaxhuesi i mjeteve nuk mund të shpërndajë dividendë pa miratim paraprak nga BQK-ja.

Neni 13 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 4 mbi Licencimin e Menaxherëve të Mjeteve të Pronave të Pensionit të datës 7 shkurt 2007.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Bedri Peci